



SESION TRAJNIMI

**Asistenca financiare e BE,
si të shkruajmë një
projekt-propozim**



Shkurt 2017



Albania – Kosovo


IPA Cross Border Cooperation Programme

© Të gjitha të drejtat të rezervuara

Le të fillojmë...



- **Prezantoni veten**
- **Përvoja në zbatimin e projekteve me financim të huaj, përfshi projektet e financuara nga BE**
- **Pritshmëritë tuaja nga ky sesion trajnimi**





Si do organizohemi?

- Prezantime
- Ushtrime
- Shkëmbim
eksperiencash
- Diskutime
- Punë në grup
- Socializim
- Shkëmbejme
kontakte

Interaktive



Pse?

Sepse ne mbajmë mend:

- 10% të asaj që lexojmë
- 20% të asaj që dëgjojmë
- 30% të asaj që shikojmë
- 50% të asaj që shikojmë dhe dëgjojmë
- 80% të asaj që themi
- **90% të asaj që bëjmë**



Pak rregulla



- Jini aktiv
- Jini pozitivë
- Diskutoni por mos flisni ndërkohë që dikush tjetër po flet
- Respektoni oraret
- No smoking
- Telefonat mbajini në vëmendje por me zile të ulët



OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT



Në fund të sesionit do të jemi në gjendje të :

- **Kemi një kuptim të qartë mbi mekanizmat e financimit të Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Shqipëri**
- **Kuptojmë çfarë është IPA dhe cila është perspektiva financiare IPA II (2014-2020), baza ligjore, dokumentat...**
- **Bëjmë dallimin mes Programeve të ndryshme që financojnë BE: Programet Kombëtare, Programet e Bashkëpunimit Territorial, Programet e Unionit, etj.**
- **Dimë se si mund të aplikojmë në kuadër të Thirrjes së Parë për propozime, Programi AL-KS 2014-2020**
- **Dime çfarë janë PROSPECT, PADOR**



- Çfarë është IPA?**
- Çfarë është IPA II (2014-2020)**
- Dokumentat dhe baza ligjore e IPA II**
- Programet Kombëtare të IPA-s**
- Programet IPA me Shumë përfitues**
- Programet e Bashkëpunimit Territorial**
- Programet e Unionit**


Çfarë është IPA?



IPA – Instrument of Pre-accession Assistance-
Instrumenti i Asistencës së para-Aderimit

**Deri në Janar 2007: INTERREG,
PHARE, CARDS, SAPARD,
dhe instrumenti per Turqinë**

TANI – NJË BAZË E VETME LIGJORE



Alokimet e IPA I (2007-2013) në Mln Euro



Shteti/Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	61.0	70.7	81.2	94.1	94.4	94.5	95.3
Bosnia & Herzegovina	62.1	74.8	89.1	105.3	107.4	107.8	63.6
Kroacia	141.2	146.0	151.2	153.5	156.5	156.1	93.5
Maqedonia	58.5	70.2	81.8	91.6	98.0	101.8	113.2
Islanda	-	-	-	-	12.0	12.0	5.8
Kosova	68.3	184.7	106.1	67.3	68.7	68.8	71.4
Mali i Zi	31.4	32.6	34.5	33.5	34.1	35.0	34.5
Serbia	189.7	190.9	194.8	197.9	201.8	202.0	208.3
Turqia	497.2	538.7	566.4	653.7	779.9	860.2	902.9

Çfarë është IPA II?



2007-2013 – Ka qënë në zbatim IPA I – e njohur edhe si perspektiva e parë e IPA-s

2014-2020 – Fillon zbatimin IPA II – e njohur edhe si perspektiva e dytë e IPA-s

Vendet përfituese të IPA II: 1) Shqipëria 2) Bosnje dhe Herzegovina 3) Islanda 4) Kosova 5) Mali i Zi 6) Serbia 7) Turqia 8) Maqedonia

Buxheti total i IPA I (2007-2013) → 11.5 Miliard Euro

Buxheti total i IPA II (2014-2020) → 11.7 Miliard Euro

Baza Ligjore e IPA II



Dy Rregullore të BE shërbejnë si baza themelore ligjore e Instrumentit IPA II:

-Rregullorja Nr. 231/2014, datë 11.03.2014 “Për themelimin e Instrumentit IPA II” – njohur si rregullorja IPA

-Rregullorja Nr. 447/2014, datë 02.05.2014 “Mbi rregullat specifike për zbatimin e Instrumentit IPA II” – njohur si Rregullorja zbatuese e IPA II

Gjithashtu:

- Rregullorja Nr. 236/2014, datë 11.03.2014 “Mbi rregullat dhe Procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumentave financiare të BE”

IPA si pararendëse e *fondeve strukturore*: ESF – European Social funds, EDF – European Development Fund, ERDF – European Regional Development Fund, etj.

Objektivat specifike të IPA II



- mbështetje për reformat politike
- mbështetje për zhvillimin ekonomik, social dhe territorial
- forcim i aftësisë së shteteve përfituese për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE, duke mbështetur përafrimin gradual si dhe zbatimin e miratimin e *acquis* të BE-së
- forcim i integritimit rajonal dhe bashkëpunimit territorial

Fushat e politikave të IPA II



IPA I (2007-2013) ka patur 5 komponentë nga të cilat Shqipëria përfitonte vetëm nga 2. Ndërsa IPA II (2014-2020) nuk ka komponentë por 5 fusha politikash (policy area). Të teta vendet përfituese mund të përfitojnë në të pesta fushat:

- a) reformat në përgatitje për anëtarësim në BE si dhe forcimin institucional dhe të kapaciteteve që nevojitet në këtë drejtim,
- b) zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal,
- c) punësimi, politikat sociale, arsimit, nxitja e barazisë gjinore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore,
- d) zhvillimi bujqësor dhe rural,
- e) bashkëpunimi rajonal dhe territorial.

KUJDES!! Asistenca e BE-së është vetëm një nga mjetet për të arritur përparimin e nevojshëm. Kur përcaktohen prioritetet, merren parasysh mirë edhe mjetet e vetë përfituesit dhe mbështetja e dhënë nga aktorë të tjerë, në veçanti donatorët dypalësh apo institucionet financiare ndërkombëtare.



- Marrëveshja Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II) – nënshkruar në Shkurt 2015
- Marrëveshja Kornize (Framework Agreement) ka 9 Seksione dhe është në total 66 faqe (pa Anekset).
- Marrëveshja Kuadër përcakton edhe aktorët kryesorë në planifikimin dhe zbatimin e asistencës financiare IPA II në Shqipërisë



Neni 6 - Parimi i pronësisë

Pronësinë për programimin dhe zbatimin e asistencës IPA II e ka kryesisht Përfituesi IPA II

Përfituesi IPA II emëron Koordinatorin Kombëtar IPA (KKIPA - NIPAC) që shërben si strukturë homologe e Komisionit për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, bashkërendimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA II.


KKIPA është përfaqësues i lartë i qeverisë apo i administratës kombëtare të Përfituesit IPA II, që gëzon autoritetin e duhur.

Në rastin e Shqipërisë: KKIPA -NIPAC është Ministri i Integritetit Evropian

Dokumenti Strategjik Kombëtar (DSK)



- Country Strategy Paper (CSP) - Secili shtet përfitues ka një të tillë
- Hartuar **bashkarisht** mes KE dhe secilit shtet përfitues.
- DSK përcakton prioritetet e asistencës financiare të BE-së për periudhën 2014-2020 për të mbështetur **Shqipërinë** në rrugën e saj drejt anëtarësimit. Ai përkthen prioritetet politike të përcaktuara në kuadrin e politikës së zgjerimit **në fusha kyçe** ku asistenca financiare është më e dobishme për të përmbushur kriteret e anëtarësimit.





Nisur nga vlerësimi i nevojave të vetë Shqiperise dhe nga konstatimet e Komisionit, është vendosur që ndihma e para-anëtarësimit për periudhën 2014-2020 të fokusohet në **Sektorët** e mëposhtëm:

1. Demokracia dhe Qeverisja
2. Shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore
3. Mjedişi dhe masat për klimën
4. Transporti
5. Konkurrueshmëria dhe inovacioni
6. Arsimi, punësimi dhe politikat sociale
7. Bujqësia dhe Zhvillimi rural
8. Bashkëpunimi Territorial



- Çdo vit Shqipëria Programon dhe dërgon për miratim në Komisionin Evropian atë që njihet si Programi Vjetor Kombëtar i Veprimit
- Kryesisht përfitues janë institucionet qendrore, përgjegjëse për zbatimin e reformave të kërkuara në kuadër të integritimit
- Risia: sugjerohet shmangia e projekteve të veçuara (ad-hoc) dhe promovohet qasja sektoriale → **Mbështetja Buxhetore Sektoriale**



BE derdh në buxhetin e shtetit për sektorin përkatës shumën e dedikuar për financim. Alokimet e BE bashkohen me alokimet e buxhetit kombëtar dhe bashkarisht realizojnë ndërhyrjet e parashikuara në sektorin përkatës

Programet IPA Shumë Vendësh



Programi Ofron Asistencë përmes katër kanaleve:

- **Mbështetje Horizontale** – Asistencë teknike, trajnime, projekte binjakëzimi, informacion për nëpunësit e administratave të vendeve përfituese
- **Financimi i Strukturave dhe Rrjeteve rajonale** – Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA), Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit, Rrjeti i Prokurorëve, Komuniteti i Energjisë, etj
- **Mbështetje e Investimeve Rajonale** – Kuadri i Investimeve në BP (WBIF), Fondi i Gjelbër për Zhvillim, Fondi Evropian për Evropën Juglindore, Programi Rajonal i Strehimit, etj.
- **Bashkëpunimi Territorial** – financimi i Programeve të bashkëpunimit territorial (Programet e bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Programet Transnacionale)

IPA Shumë Vendësh → Menaxhohet nga Brukseli direkt.



BASHKËPUNIMI TERRITORIAL

- A. Programet e bashkëpunimit Ndërkufitar – Cross Border Cooperation Programmes**

- B. Programet Transnacionale – Transnational Cooperation Programmes**

Njësitë e Qeverisjes Qendrore, Lokale, OJF mund të përfitojnë nga këto Programe

Programet e Bashkëpunimit Territorial (1)



Programet e Bashkëpunimit Territorial ndahen në:

- ❖ **Programe bilaterale të Bashkëpunimit Ndërkufitar** – Cross Border Cooperation (CBC) – si rregull në këto Programe marrin pjesë 2 vende që ndajnë kufi të përbashkët. Mund të jenë Programe të përbashkëta mes: i) dy vendeve IPA; iii) një vendi IPA dhe një vendi anëtar të BE; iii) dy vendeve anëtare të BE (fondet ERDF)
- ❖ **Programe Trilaterale të Bashkëpunimit Ndërkufitar** - CBC – Marrin pjesë 3 vende që ndajnë kufi të përbashkët. Projektet duhet të kenë të paktën nga një partner nga secili vend
- ❖ **Programe Transnacionale** – Transnational Programmes – Janë Programe të mëdha me mbi 5 shtete pjesëmarrëse. Në çdo rast janë një miks vendesh anëtare të BE dhe jo-anëtare (ERDF+IPA)

Programet e Bashkëpunimit Territorial (2)



Programet hartohen nga **vetë shtetet pjesëmarrëse** në to dhe miratohen nga Komisioni Evropian.

Programet **kanë një shtrirje 7 vjeçare** dhe në të parashikohen alokimet financiare, autoritetet menaxhuese të Programit, zonat e lejueshme si edhe prioritetet e mundshme për financim.

Pas hartimit të Programit dhe miratimit të tij nga Komisioni Evropian i hapet rruga **lancimit të thirrjeve për projekte** për secilin prioritet dhe në këtë mënyrë një program gjeneron një numër të konsiderueshëm projektesh që implementohen.

Aktualisht projektet e financuara nën perspektivën e IPA I (2007-2013) janë drejt përfundimit dhe Programet e reja të Bashkëpunimit Territorial kanë lançuar thirrjet e para për projekt-propozime së shpejti



1. Nivel lokal

Hapësirë për adresim të problemeve të identifikuara në nivel lokal dhe rritje të kapaciteteve duke përballuar këto sfida

2. Nivel rajoni

Promovim i marrëdhënieve të mira të fqinjësisë, duke nxitur balancim të zhvillimit të qëndrueshëm

3. Integrimin në BE

Forcim të kapaciteteve menaxhuese të administratës qendrore dhe lokale, për t'u përballur me kërkesat e BE dhe rritje të kapaciteteve thithëse të fondeve të BE-së

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Programet e Bp. Territorial (1) – 2014-2020



Gjatë perspektivës 2014-2020 Shqipëria merr pjesë në 8 Programe të Bp. Territorial:



Katër Programe Bilaterale:

- ✓ Programi IPA CBC Shqipëri-Kosovë
- ✓ Programi IPA CBC Mali i Zi-Shqipëri
- ✓ Programi IPA CBC Maqedoni-Shqipëri
- ✓ Programi IPA CBC Greqi-Shqipëri

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Programet e Bp. Territorial (2) 2014-2020



Një Program Trilateral:

- ✓ Programi Interreg - IPA Itali – Shqipëri – Mali i Zi

Tre Programe Transnacionale:

- ✓ Programi Transnacional Balkan-Med (Shtetet pjesëmarrëse: Greqia, Bullgaria, Qipro, Shqipëria, Maqedonia)
- ✓ Programi Transnacional Adriatiko-Jonian - **ADRION** (Shtetet pjesëmarrëse: Italia, Greqia, Sllovenia, Kroacia, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja) – Në sinergji me Strategjinë e BE për Adriatikon & Jonin
- ✓ Programi Transnacional Mediterranean – MED (shtetet pjesëmarrëse: Qipro, Franca, Greqia, Italia, Malta, Portugalia, Sllovenia, Spanja, Mbretëria e Bashkuar, Kroacia, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnje & Hercegovina)



Programet Bilaterale:

- ✓ **IPA CBC Shqiperi – Kosove**
- ✓ **IPA CBC Kosove – Maqedoni**
- ✓ **IPA CBC Mali i Zi – Kosove**



Zonat e lejueshme nga ana shqiptare:

- ✓ Qarku i Kukësit
- ✓ Qarku i Lezhës

Programi është në vazhdimësi të Programit 2007-2013

Programi IPA CBC Shqipëri-Kosovë



Programi u miratua nga Komisioni Evropian më datë 11 Dhjetor 2014.

Objektivi i Përgjithshëm: Promovimi i qëndrueshmërisë socio-ekonomike në zonat ndërkufitare duke nxitur bashkëpunimin midis individëve, institucioneve dhe komuniteteve.

Prioritetet: → Mbrojta e mjedisit, promovimi i adaptimit dhe zbutja ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;
→ Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore;
→ Investimi për rininë, Edukimin dhe aftësitë.

Alokimet financiare per 7 vite - 9.734.118 Euro

Thirrjet për projekt propozime dhe projektet strategjike: Thirrja e parë është lancuar në 11 Janar 2017

Website i Programit: <http://albaniakosovo.org/>

Programet Evropiane



- Programet Evropiane nxisin bashkepunimin ne fusha qe lidhen me politika te ndryshme te BE-se
- Programet shume-vjetore – objektiva te percaktuara, si dhe nje buxhet perkates
- Cdo Program percakton rregullat e veta per pjesemarrje.
- Te gjitha Vendet Anetare te BE-se jane te pranueshme per te marre pjese ne Programet Evropiane (UP).
- Vendet Kandidate per ne BE mund te marrin pjese nepermjet nje marreveshjeje specifike me sherbimet e Komisionit Evropian, si dhe duke kontribuar financiarisht.

PROGRAMET EVROPIANE – IPA



IPA

- Synon ekskluzivisht **Vendet Kandidate**
- Projektet kryesisht synojne **autoritetet kombetare** – si dhe jane te lidhura ngushte me adoptimin e legjislacionit te BE-se
- **Nuk kerkohet Pagesa per Pjesemarrje** (ose bileta hyrese) Entry ticket – por bashke-financim individual per projektin qe aplikohet
- Menaxhohet nga **strukturat kombetare**
- Baza ligjore – ka **rregulla te perbashketa** zbatimi

Programet Evropiane

- **Kryesisht synon Vendet Anetare te BE-se** ne zonen e perbashket te politikave te BE-se
- Projektet perfshijne **institucione/organizata qe veprojne ne partneritet** nga vende te ndryshme anetare te BE-se
- **Kerkohet Pagesa per Pjesemarrje** (ose bileta hyrese) ne nivel Programi + bashke-financim ne nivel projekti
- **Shpesh menaxhohet nga sherbimet e Komisionit Evropian apo agensi te specializuara te BE-se**
- Baza ligjore – ka **rregulla spefiike zbatimi** per cdo Program

Programet Evropiane ne Shqiperi



HORIZON 2020 – *Kerkim dhe Inovacion*



COSME – *Konkurrueshmeria e SME-ve*



ERASMUS PLUS – *Edukim, Trajnim, Rinia dhe Sportet*



CREATIVE EUROPE – *Media dhe Kultura*



EUROPE FOR CITIZENS – *Identiteti Evropian*



EaSI – *Punesimi dhe Inovacioni Social*



CUSTOMS 2020 – *Bashkepunimi ne fushen e doganave*



FISCALIS – *Bashkepunimi ne fushen e tatimeve*



Ku te gjeni informacion te perditesuar???

Uebsite i Ministrisë së Integritimit Evropian:

www.integrimi.gov.al

Uebsite i Ministrise se Administrimit te Pushtetit Lokal:

www.mapl.rks-gov.net



Gjithashtu:

gentian.xhaxhiu@integrimi.gov.al



Cikli i Menaxhimit të Projektit


PCM

Cikli i Menaxhimi të Projektit

- Shumica e modeleve ekzistuese e shikojne projektin si nje cikel te quajtur “Project cycle management” - PCM
- Kjo qasje ndiqet edhe nga Bashkimi Evropian ne rastin e te gjitha financimeve qe ai akordon ne vende anetare apo jo-anetare te BE.
- Manuali i PCM mund te shkarkohet ne linkun e meposhtem:

https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/methodology-aid-delivery-methods-project-cycle-management-200403_en_2.pdf

Cikli i Menaxhimi të Projektit





- Ne cdo faze te ciklit nuk shmangim dot:
 - Marrjen e Vendimeve te rendesishme
 - Ndarjen e informacionit me koleget dhe partneret
 - Marrjen persiper te pergjegjesive
- Te gjitha fazat jane “progresive” – njera nuk fillon, pa mbaruar paraardhesja
- Kur kalohet nga nje faze ne tjetren duhet te:
 - Vleresojme cfare kemi arritur
 - Mesojme vazhdimisht, shkembjme eksperiencen, komunikojme



- Në mënyre që të kuptoni nëse një projekt është formuluar mirë apo jo, duhet lehtësisht t'i përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- Pse?
- Çfarë?
- Për kë?
- Si?
- Kush?
- Sa?
- Ku?





THANK
YOU !